

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Kuvendi i Komunës Dragash**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **621-25-8536-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **077-Hartimi i planit zhvillimor Komunal 2025-2035 - Dragash**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë "INSI" SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Bregu i Diellit, Qendra Tregtare, nr. 42.,
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

044 999 007
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Ismajl Baftijari
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

baftijari@gmail.com
(Adresa elektronike)

09.10.2025
(Data e parashtrimit të ankesës)


(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim: *N/A*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 18.09.2025
Afati i fundit i dorëzimit të tenderëve: 30.10.2025
Kërkesë për Rishqyrtim: 26.09.2025
Përgjigje ndaj Kërkesës për Rishqyrtim: 30.09.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., fillimisht më 23.09.2025, ka parashtruar Kërkesë për Informacione Shtesë, ndërkaq më 26.09.2025, ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim ndaj Kuvendit të Komunës së Dragashit, duke i prezantuar vërejtjet tona ndaj disa nga kriteret e vendosura nga AK, si disproporcionale, jo relevante me natyrën e kontratës dhe njëkohësisht kufizuese të konkurrencës së drejtë.

Megjithatë, në refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues nuk ofron ndonjë kundër argument ligjor në argumentet tona ligjore dhe padrejtësisht refuzon kërkesën e parashtruar.

Duke pas parasysh të cekurat më lartë, Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI”

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 4.3 i Rregullores për Prokurim Publik

Neni 25.17 i Rregullores për Prokurim Publik

Neni 18 i Direktivës 2014/24/EU

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kuvendi i Komunës së Dragashit, më 18.09.2025 ka publikuar Njoftimin për Kontratë për Aktivitetin e Prokurimit: **077-Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal 2025-2035, me numër prokurimi: 621-25-8536-2-1-1**, ndaj të cilit Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim më 26.09.2025, sa i përket kriterëve të vendosura për disa nga ekspertët dhe pajisjet e kërkuara.

Ndërkaq, më 30.09.2025, AK Kuvendi i Komunës së Dragashit ka refuzuar Kërkesën tonë për Rishqyrtim pa dhënë ndonjë argument të bazuar ligjor mbi arsyen e refuzimit.

INSI pas vlerësimit dhe analizimit të kriterëve të vendosura dhe përgjigjes në kërkesën për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues, konsiderojmë se në këtë aktivitet të prokurimit kriteret për të cilat kemi parashtruar kërkesën për rishqyrtim janë disproporcionale, jo relevante me natyrën e kontratës dhe kufizuese të konkurrencës së drejtë, duke rënë ndesh me dispozitat ligjore të Prokurimit Publik.

Andaj, Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., brenda afatit ligjor, pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit paraqet këtë ankesë dhe atë mbi këto pretendime ankimore:

Pretendimi 1:

Kriteri 2.7 – Inxhinieri i diplomuar/Master i Inxhinierisë Kompjuterike i certifikuar me PMP është jo relevant me natyrën dhe qëllimin e kontratës

Autoriteti Kontraktues në përgjigjen ndaj Kërkesës për Rishqyrtim ka arsyetuar se ky

profil është i nevojshëm për: GIS, transformim digjital, Smart City, siguri kibernetike dhe menaxhim projektesh.

Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., e kundërshtojmë në tërësi një përgjigje të tillë, sepse të cekurat më lartë nga AK, janë tema të rëndësishme, por në këtë rast janë jo relevante dhe nuk janë pjesë përbërëse e kërkesave ligjore dhe përmbajtjes standarde të një PZHK-je. Sepse, PZHK nuk është projekt IT apo Smart City, por është një dokument planifikimi hapësinor i nivelit komunal, strategjik për nga karakteri dhe për hartimin e këtij lloji të dokumentit kërkesa për një ekspert të tillë është i panevojshëm dhe nuk është kërkuar asnjëherë më parë. Vendosja e një kërkesë të tillë që Inxhinieri i Inxhinierisë Kompjuterike të jetë i **certifikuar me PMP**, krijon një pengesë të panevojshme dhe të qëllimshme konkurruese, duke përjashtuar profesionistë të kualifikuar në inxhinieri kompjuterike që mund të kontribuojnë në projekt, por që nuk kanë këtë certifikim specifik të panevojshëm për objektin e kontratës.

PMP është një certifikatë ndërkombëtare që lidhet me menaxhimin e projekteve që kanë për bazë kryesisht procese, burime dhe shpesh zhvillim të sistemeve IT.

Andaj, ky kriter si i tillë bie ndesh me **Nenin 1 të LPP-së**, sepse përcaktimi i një kërkesë të tillë nuk përmbushë qëllimin e prokurimit publik për përdorim efikas të fondeve publike, pasi kërkesa për PMP nuk ka vlerë të shtuar për kontratën. **Nenin 7 të LPP-së dhe Nenin 18 të Direktivës 2014/24/EU**, sepse kushtëzimi me një certifikatë specifike siç është PMP diskriminon operatorët që kanë ekspertizë relevante (planifikim hapësinor, urbanizëm). Si dhe **Nenin 4.3 të Rregullores për Prokurimin Publik**, sepse kriteri nuk është proporcional me natyrën e kontratës, si dhe **Nenin 25.17 të Rregullores për Prokurimin Publik**, sepse sipas kësaj dispozite kriteret duhet të jenë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, gjë që nuk ndodh në këtë rast.

Praktika e komunave të tjera (p.sh. Ferizaj, Obiliq, Gjakovë, Shtërpçë, Suharekë etj) tregon qartë se asnjë PZHK i hartuar më parë në Kosovë nuk ka pasur kriter të tillë.

Andaj, kërkojmë që ky kriter të ndryshohet duke e hequr kushtin për certifikatën PMP, si jo relevante me natyrën dhe qëllimin e kontratës.

Pretendimi 2:

Kriteri 2.9 – Dy gjeodetë të licencuar dhe të certifikuar për GIS është kriter kufizues dhe diskriminues

Autoriteti Kontraktues në përgjigjen ndaj Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar nga INSI ka arsyetuar se dy gjeodetë janë të domosdoshëm për shkak të: volumit të punës hartografike, kompetencës ligjore për gjeoreferencim, dhe cilësisë së të dhënave.

Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., e kundërshton në tërësi këtë përgjigje të AK, dhe atë sepse Ligji për Planifikim Hapësinor nuk kërkon matje të reja gjeodezike në kuadër të PZHK-së. PZHK kërkon përdorim të dhënave të dokumentuara kadastrale, hartave ekzistuese nga Drejtoria e Kadastrit, Agjencioni Kadastral i Kosovës (parcela, zona kadastrale, ortofoto, harta kadastrale, materiale nga AKK, ASK, MMPHI, etj.) dhe shfrytëzimin dhe integrimin e të dhënave të dokumentuara, jo matje të parcelave kadastrale dhe vendosje pronarësh (është e palejueshme që një kompani konsulente gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të bëjë matje, ndarje, e vendosje emrash të pronarëve). Gjatë hartimit të PZHK-së bëhet integrimi dhe shfrytëzimi i të dhënave kadastrale nga komuna dhe AKK për analiza të shfrytëzimit të tokës aktual dhe të planifikuar, ndërtim konceptesh e planifikim zhvillimi ekonomik, infrastrukturë publike e sociale, analiza të hapësirave dhe kostove të shpronësimit, e që të njëjtat guxojnë të përdoren vetëm si të dhëna zyrtare.

Po ashtu, nuk ekziston asnjë bazë ligjore që kërkon që hartat brenda një PZHK-je të nënshkruhen nga gjeodetë të licencuar, pasi që të njëjtat mund të punohen edhe nga ekspert të tjerë si gjeografë, planer, urbanistë, arkitekt, etj.

Për më tepër, kriteri që vetëm gjeodetët të jenë të certifikuar me GIS, konsiderojmë se është kriter i tepërt dhe i pajustificuar sepse GIS është aftësi teknike ndërdisiplinore, jo monopol i gjeodetëve. GIS mund të zotërohet nga profesione të ndryshme, dhe përdoret nga urbanistë, arkitektë, planifikues hapësinor, ekspert të mjedisit, si dhe shumë profesione të tjera, andaj kërkesa që vetëm gjeodetët të kenë certifikatë GIS është diskriminuese dhe përjashton profesionistë të tjerë të kualifikuar që e zotërojnë këtë aftësi. Andaj, ky kriter është në kundërshtim me dispozitat ligjore, përkatësisht me **Nenin 7 të LPP-së dhe Nenin 18 të Direktivës 2014/24/EU**, sepse si i tillë është diskriminues dhe kufizon konkurrencën, duke përjashtuar kështu profesionistët e tjerë me kualifikime të barabarta për GIS, si dhe **Nenin 25.17 të Rregullores për Prokurim Publik**, sepse ky kriter nuk lidhet ngushtë me natyrën e kontratës, pasi që GIS është aftësi teknike ndërdisiplinore.

Praktika në të gjitha PZHK-të e deritanishme në Kosovë tregon se nuk është kërkuar kurrë një kriter i tillë.

Andaj, kërkojmë që ky kriter të ndryshohet duke e larguar kërkesën për gjeodetë të certifikuar me GIS, si një kriter kufizues dhe diskriminues për profesionist të fushave të tjera që përdorin GIS si mjet profesional, ashtu që si kërkesë të mbetet e pakufizuar në profesion të caktuar.

Pretendimi 3:

Kriteri 3 – Pajisjet gjeodezike të avancuara si

- **Dron me kamerë minimum 45 MP, i pajisur me sensor LIDAR me mundësi të marrjes minimum 240 000 pika në sekond, me mundësi operimi në RTK dhe PPK, bazë dhe software aplikacion për përpunimin e të dhënave dhe të ofroj mundësi operimi në ajër minimum 55 minuta**
- **Dy (2) pajisje gjeodezike për rilevim të pikave – Stacion Total Robotic, që të paktën njëri nga ta të jetë full robotic dhe me saktësi të matjes këndore jo më pak se 1”**
- **Dy (2) pajisje për rilevim të pikave GNSS (bazë+rover) me mundësi operimi në RTK dhe matje statike**
- **Një (1) Softuerë për barazim të pikave gjeodezike**
- **Një (1) marrës LIDAR (laser scanner) të dorës, me mundësi të skanimit minimum 200 000 pika në sekond dhe operim minimum 2 x 90 minuta me mundësi operimi RTK dhe minimum 2 kamera të integruara me nga 12 MP secila**
- **Një (1) Dron profesional i aplikueshëm në gjeodezi me min. 40 MP dhe mundësi operimi në RTK dhe i pajisur me sensor termal**

Të gjitha këto pajisje janë disproporcionale me objektin e kontratës për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal

Autoriteti Kontraktues në përgjigjen ndaj Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar nga INSI ka arsyetuar se kriteri për pajisjet si dron me LIDAR, stacione totale robotike, GNSS, dhe softuerë barazimi janë të domosdoshëm për ortofoto të sakta dhe integrim në GIS.

Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., e kundërshtojmë në tërësi një përgjigje të tillë, dhe e konsiderojmë si **jashtëzakonisht disproporcionale dhe të pajustificuar**, pasi që hartimi i PZHK-së nuk kërkon matje gjeodezike të reja, por përdor të dhënat gjeodezike të dokumentuara zyrtare dhe të dhënat ekonomike, mjedisore të shfrytëzimit të tokës, të dhënat e infrastrukturës, dhe një numër të dhënash të organizuara mbi 2000 tregues, si të dhëna bazë për profil, analizë, zhvillim të koncepteve hapësinore, qëllimeve, objektivave, prioriteteve strategjike. Pra, nuk kërkon rilevime topografike të reja, por i përdor të gatshme të dhënat ekzistuese të dokumentuara kadastrale nga Drejtoria e Kadastrit, ASK, dhe AKK. PZHK është dokument strategjik që nuk kërkon

pajisje të avancuara gjeodezike të përdorura për matje milimetrike në terren. Kërkesa për një gamë kaq të gjerë pajisjesh i shkon përshtat një kontrate të natyrës inxhinierike apo specifike topografike/gjeodezike, por jo një dokumenti politikash zhvillimore dhe hapësinore sikurse është hartimi i një Plani Zhvillimor Komunal.

- **Dron me kamerë 45 MP, i pajisur me sensor LIDAR (240.000 pika/sekondë)**

Kjo pajisje është e përshtatshme për projekte të inxhinierisë së lartë civile (autostrada, tunele, hekurudha, projekte të mëdha infrastrukturore), ku kërkohet modelim 3D me densitet të lartë të pikave. Për një PZHK i cili është dokument i planifikimit strategjik, i bazuar në analiza socio-ekonomike, hapësinore dhe urbane, të dhënat kryesore (ortofoto, harta kadastrale, zonat kadastrale, parcelat) janë si kërkesë që të jenë të dokumentuara dhe duhet të sigurohen nga Komuna në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, dhe ASK. Prandaj, kërkesa për pajisje LIDAR me specifika kaq të larta është disproporcionale dhe pa lidhje me natyrën e kontratës.

- **Dy (2) pajisje GNSS (bazë + rover, RTK dhe matje statike)**

GNSS përdoret për matje të koordinatave me saktësi centimetri për qëllime inxhinierike, ndërtimore dhe kadastrale. PZHK nuk është projekt i tillë, por dokument zhvillimor që punon me të dhëna ekzistuese gjeoreferencuese. Nuk ka nevojë për operatorin ekonomik të bëjë matje të reja GNSS, pasi këto nuk janë pjesë e procesit ligjor dhe teknik për hartimin e PZHK-së, dhe si i tillë është kriter joproporcional dhe i vendosur kundërligjshëm për favorizim të ndonjë kompanie gjeodezike.

- **Softuer për barazim të pikave gjeodezike**

Ky softuer përdoret në projektet gjeodezike për harmonizim të të dhënave të matjeve në terren (nivelim, triangulum, matje statike GNSS). PZHK nuk kërkon rilevime të tilla dhe as përpunim të të dhënave primare gjeodezike. Përpunimi i të dhënave në PZHK bazohet në GIS dhe analiza hapësinore, jo në barazim të pikave gjeodezike, dhe si e tillë është kërkesa e pajustificuar.

- **Marrës LIDAR i dorës (200.000 pika/sekondë, 2 x 90 min, 2 kamera 12 MP)**

Një pajisje e tillë përdoret për skanime 3D të brendësive të objekteve ose monumenteve, në projekte restaurimi, arkeologjie ose rilevime shumë precize. Kjo nuk është pjesë e objektit të kontratës për hartimin e PZHK-së, që trajton planifikimin në nivel strategjik dhe jo dokumentim me skanime 3D të ndërtesave dhe si e tillë kjo kërkesë është disproporcionale dhe pa relevancë.

- **Dron profesional për gjeodezi (40 MP, RTK, sensor termal)**

Edhe ky dron është pajisje tipike për survejim inxhinierik, rilevime të terrenit, monitorim të infrastrukturës dhe përdoret për qëllime teknike të avancuara. Për një PZHK nuk ka nevojë për sensor termal apo për rilevime RTK të reja, pasi analizat për PZHK mbështeten në të dhënat ekzistuese dhe të publikuara nga institucionet shtetërore, andaj si i tillë ky kriter është joproporcional me kontratën.

Për më tepër, fakti që është kërkuar që këto pajisje të dëshmohen vetëm përmes faturës tatimore ose DUD-it doganor, përjashton mundësinë e zakonshme të sigurimit përmes qirasë apo marrëveshjeve të tjera të ligjshme, duke kufizuar kështu panevojshëm konkurrencën.

Detyrimi për posedim të këtyre pajisjeve rrit artificialisht kostot e ofertës dhe potencialisht shkakton dëm për buxhetin publik.

Praktikat në të gjitha komunat e Kosovës dhe rajonit tregojnë se PZHK-të janë hartuar pa kërkesa të tilla, duke u mbështetur në të dhënat ekzistuese zyrtare. Këto pajisje përdoren për projekte të specializuara teknike (infrastrukturë, rrugë, ndërtim, etj), jo për hartimin e një Plani Zhvillimor Komunal.

Andaj, ky kriter është në kundërshtim të plotë me **Nenin 4.3 të Rregullores për**

Prokurimin Publik dhe Nenin 18 të Direktivës 2014/24/EU, sepse si e tillë kjo kërkesë është joproportionale me objektin e kontratës dhe krijon barrierë artificiale për operatorët, si dhe **Nenin 7 të LPP-së dhe Nenin 25.17 të Rregullores për Prokurimin Publik**, sepse cenon barazinë dhe diskriminon operatorët ekonomik që përdorin forma të tjera ligjore sigurimi të pajisjeve.

Andaj, kërkojmë që ky kriter të largohet si disproporcionale me objektin e kontratës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Për më shumë, Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., si kompani me përvojë të gjatë në fushën e planifikimit hapësinor, gjegjësisht, hartimin e Planeve Zhvillimore Komunale, konsideron se kërkesat e parashtruara nga AK nuk janë në harmoni me natyrën, përmbajtjen dhe praktikën ligjore për hartimin e një PZHK-je.

Plani Zhvillimor Komunal është një **dokument strategjik dhe planifikues**, i cili mbulon këto fusha kryesore tematike:

- Karakteristikat e përgjithshme të komunës dhe demografia
- Fusha ekonomike
- Fusha e infrastrukturës teknike
- Fusha e infrastrukturës së transportit
- Fusha e infrastrukturës publike dhe sociale
- Fusha e mjedisit dhe zonave me rrezikshmëri
- Fusha e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike
- Fusha e vendbanimeve
- Fusha e banimit
- Fusha e vendbanimeve joformale (VJF)
- Fusha e shfrytëzimit të tokës

PZHK përfshin analizën e gjendjes ekzistuese, vizionin zhvillimor, objektivat, kornizën hapësinore, projektet prioritare, planin e veprimit, mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimin e kapaciteteve investive. Në këtë kuptim, është e qartë se dokumenti është **politikë zhvillimore dhe planifikim strategjik hapësinor**, dhe jo një proces matjesh gjeodezike apo ndërtimi hartash teknike në nivel milimetrik.

Deri më sot, asnjë komunë në Kosovë apo rajon nuk ka kërkuar profile të tilla për hartimin e PZHK-së, andaj edhe kjo tregon qartë se kërkesat e vendosura nuk janë as të domosdoshme, as të bazuara në legjislacionin për planifikim hapësinor. Përkundrazi, ato krijojnë pengesa artificiale për konkurrencë, duke e orientuar tenderin në favor të një grupi të caktuar operatorësh ekonomikë.

Andaj, mbi bazën e të sipër përmendurave, Organit Shqyrtues të Prokurimit, i propozojmë që të merr këtë:

VENDIM

- 1. APROVOHET si e bazuar** Ankesa e paraqitur nga Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë „INSI“ SH.P.K.
- 2. TË OBLIGOJ** Autoritetin Kontraktues që të ndryshojë kriteret e FDT-së, duke larguar kërkesën për:
 - **Certifikatën PMP për inxhinierin e inxhinierisë kompjuterike**
 - **Certifikatën GIS për gjeodetët**
 - **Pajisjet e avancuara të detyrueshme dhe të dëshmuara vetëm me**

pronësi

3. Meqë Ankesa është aprovuar si e bazuar, OE Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë „INSI“ SH.P.K., i kthehet tarifa e deponuar në emër të ankesës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që shkaktohen nëse aplikohen pikat 2.7, 2.9, dhe 3 të FDT-së, dhe pamundësia e pjesëmarrjes në këtë aktivitet të prokurimit, janë të konsiderueshme si në fushën financiare, ashtu edhe në fitime të munguara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

NJOFTIM PËR KONTRATË

 PUNË FURNIZIM SHËRBIME

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: **18.09.2025**

Nr i Prokurimit	621-25-8536-2-1-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI		
Adresa Postare: DRAGASH		
Qyteti: DRAGASH	Kodi postar: 22000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Fadil Sinani		Telefoni: +383 03820045509
Email: Fadil.Sinani@rks-gov.net		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet): https://dragash.rks-gov.net/		

Po



Jo



Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po



Jo



Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
077-Hartimi i planit zhvillimor Komunal 2025-2035- Dragash

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit
(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

<input type="checkbox"/> Punë	<input type="checkbox"/> Furnizime	<input checked="" type="checkbox"/> Shërbime
<input type="checkbox"/> Ekzekutim <input type="checkbox"/> Plani dhe ekzekutimi <input type="checkbox"/> Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	<input type="checkbox"/> Blerja <input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing) <input type="checkbox"/> Qira <input type="checkbox"/> Blerje me këste <input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
Dragash

II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë

II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet):

Kontrate publike kornizë me një operator

Kontrate publike kornizë me disa operator

Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë

Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës

Realizimi i këtij Plani është obligim Ligjor që të Zhvillohen të gjitha projektet dhe interesat e qytetarëve sipas planit.

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

93000000-8

II.1.7) Variantet pranohen

Po Jo

II.1.8) Ndarja në Pjesë

Po Jo

Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)

vetëm një pjesë Të gjitha pjesët

II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen)

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër

Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:

II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 150,000.00

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)
Realizimi i këtij Plani është obligim Ligjor që të Zhvillohen të gjitha projektet dhe interesat e qytetarëve sipas planit.

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj **12** apo ditë (nga dhënia e kontratës)
apo
Fillimi
Përfundimi

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit

Po Jo

Nëse po, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose 10 % e vlerës së kontratës me validitet prej 30 ditëve pas përfundimit të kontratës % e vlerës së kontratës

III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):

Forma ligjore që do të merret përmes grupit do të jetë forma e përcaktuar në nenin 71 të LPP-së dhe nenin 27 të Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik

III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës

Po Jo

Nëse po, përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
1) Deklarata nën betim se Operatori Ekonomik I plotëson kushtet në bazë të nenit 65 Paragrafi 65.1 pikat 1.1; 1.2; 1.3 të LPP-s	1) Deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe e vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin-2 të dosjes së tenderit
2) Operatori ekonomik duhet të ofroj një dokument të lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit që vërteton se operatori ekonomik i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë të nenit 65 të LPP-së paragrafët 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4.1, 4.2 dhe 4.4	2) Një vërtetim i lëshuar nga Gjykata kompetente-(kopje). Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të njoftimit B 58 mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe nuk duhet të jete me I vjetër se 180 ditë nga data e lëshimit deri në datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose ftesës për ofertë. - Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi I tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në nendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi I tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së.
3) Operatori ekonomik nuk duhet të jetë delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit.	3) Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik-(Kopje). Vërtetimi kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për dhënie të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të njoftimit B 58 mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe nuk duhet të jete me I vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit deri në datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose ftesës për ofertë. - Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi I tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në nendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi I tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
1. Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin përkatës profesional, të bizneseve dhe ose të korporatave	1. Kopja e Certifikatës së biznesit së bashku me pjesët informative të biznesit.
2. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të jenë deklarues të TVSH-së	2. Kopja e certifikatës së TVSH-së të lëshuar nga Organi Kompetent
3. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë regjistruar numrin fiskal në ATK	3. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të numrit fiskal (nëse nuk është i përfshirë në certifikatën e biznesit)

<p>III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</p> <p>3. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor gjatë 3 viteve të fundit (2022,2023,2024) ka qenë jo më pak se 300 000.00 euro</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>Raportin,raportet apo vërtetimet përkatëse nga një ose më shumë banka ose deklaratat vjetore ne ATK me të cilat dëshmohet se O.E ka pasur një qarkullim financiar në tri vitet e fundit sipas kërkesës së lartshënuar,ose Kopjet e Raporteteve Financiare te Audituarra dhe certifikuarra nga ndonje firme e licencuar për kontrollim apo ndonjë auditorë i licencuar i pavarur ose Vërtetim nga Banka</p>
<p>III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:</p> <p>1.Operatori ekonomik ose grupi i Operatoreve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte që lidhen me shërbimet e planifikimit dhe projektimit hapësinor, projektimit të arkiteturës dhe inxhinierisë si projekte ideore dhe kryesore ne fushën e projektimit te objekteve tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontrat në vlere prej 225,000.00 Euro.</p> <p>2.Operatori Ekonomik duhet të deshmoj minimumin e kapacitetit të stafit profesional të nevojshëm të kompanisë me të dhënat në vijim Emri, mbiemri, profesioni, eksperiencia dhe pozicioni në kompani. Lista e Stafit Profesional, Deklarata e Menaxherit të Projektit. 2.1 Menaxheri i Kontratës - OE duhet të deshmoj se ka një Inxhinier të Diplomuar ose Master të Arkitekturës me përvoj pune min. 10 vite pas diplomimit.</p> <p>2.2 Inxhinier apo Master i Arkitekturës me përvoj pune min. 5 vite pas diplomimit.</p> <p>2.3 Inxhinier apo Master i Ndërtimtarisë Drejtimi Konstruktiv me përvoj pune min. 5 vite pas diplomimit.</p> <p>2.4 Inxhinier apo Master i Ndërtimtarisë Drejtimi Hidroteknikë me përvoj pune min. 5 vite pas diplomimit.</p> <p>2.5 Inxhinier apo Master i dip. i Mjedisit minimum pesë (5) vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit).</p> <p>2.6 Inxhinier apo Master i dip. i Elektronikes minimum pesë (5) vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit).</p> <p>2.7 Inxhinier apo Master i dip. i Inxhinierisë Kompjuterike minimum pesë (5) vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit). I Çertifikuar me PMP (Project Management Profesional</p> <p>2.8 Inxhinier i dip. i Makinerisë-Drejtimi Komunikacionit minimum pesë (5) vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit).</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>- Lista e kontratave (e nënshkruar dhe e vulosur) , Operatori ekonomik duhet të ofroj listën e kontratave te realizuara gjate tri viteve te fundit nga data e njoftimit për kontratete,origjinal, të nënshkruar dhe vulosur nga OE, të deshmuar me referenca, raporte te pranimeve teknike te shërbimeve te kryera te cilat tregojne vleren, datën.</p> <p>Lista e Stafit Profesional e nënshkruar dhe vulosur nga origjinali. Deklarata e Menaxherit të Projektit e nënshkruar nga të dyja palët origjinali. Dëshmia 2.1 deri në 2.7 CV-në e përvojës së punës Diploma- Kopje Referenca të punës Kontratë Pune kopje nese është në mardhënje të rregullt pune, ose Parakontratë apo Marrëveshje Bashkëpunimi duke specifikuar titullin e kontratës, emrin e AK si dhe numrin e prokurimit.</p> <p>CV e përvojës së punës Diploma Kopje Licenca Kopje Çertifikata Kopje Referenca të punës Kontratë Pune kopje nese është në mardhënie të rregullt pune ose Parakontratë apo Marrëveshje Bashkëpunimi duke specifikuar titullin e kontratës, emrin e AK si</p>

<p>2.9 Dy gjeodet të diplomuar me minimum 5 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit). Te jene të Licencuar nga autoriteti përkatës i Republikës së Kosovës per kryerjen e shërbimeve Gjeodezike. Të jene të Çertifikuar për GIS</p>	<p>dhe numrin e prokurimit. CV e përvojës së punës Diploma Kopje Licenca Kopje Çertifikata Kopje Referenca të punës Kontratë Pune kopje nese është në mardhënie të rregullt pune ose Parakontratë apo Marrëveshje Bashkëpunimi duke specifikuar titullin e kontratës, emrin e AK si dhe numrin e prokurimit.</p>
<p>3.Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se posedon paisjet gjeodezike si më posht Një (1) Dron të aplikueshem në gjeodezi, i pajisur me kamere minimum 45 MP, i paisur me sensor LIDAR me mundesi të marrjes minimum 240 000 pika ne sekond, droni të ofroj mundësi operimi në RTK dhe PPK, të jetë i shoqeruar me GPS baze dhe software aplikacion per perpunimin e të dhënave si dhe të ofroj mundësi operimi ne ajer minimum 55 minuta. Te gjitha paisjet dhe aksesoret e jene kompitabil me marken e vete prodhuesit. Dy (2) paisje gjeodezike per rilevim të pikave – Stacion Total Robotic. Te pakten njeri nga ta te jete full robotic dhe saktesi te matjes kendore jo me pak se 1’’ Dy (2) paisje per rilevim te pikave GNSS (baze+rover) me mundesi operimi ne RTK dhe matje statike Nje (1) Softvere per barazim te pikave gjeodezike Nje (1) marres Lidar (laser scanner) te dores, me mundesi te skanimit minimum 200 000 pika ne sekond dhe operim minimum 2 x 90 minuta me mundesi operimi RTK dhe minumum 2 kamera të integruara me nga 12 MP secila Nje (1) Dron profesional i aplikueshem ne gjeodezi me min . 40 MP dhe mundesi operimi ne RTK dhe i paisur me senzor termal.</p>	<p>3.Paisjet të Deshmohen me Faturë të rregullt tatimore apo DUD Doganor</p>

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

<p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/></p>
<p>III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar</p> <p><i>Nëse po</i>, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse</p>
<p>III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve</p> <p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/></p>

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

<p>IV.1.1) Lloji i procedurës</p>
<p><input checked="" type="checkbox"/> E hapur</p>
<p><input type="checkbox"/> E kufizuar</p>
<p><input type="checkbox"/> Konkurruese me negociata</p>

Kuotim i Çmimit

IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (*procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata*)

Në bazë të aplikacioneve të pranuar, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të riekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave (*procedurë konkurruese me negociata*)

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

Po Jo

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

Po Jo

IV.1.4 Numri minimal i kandidateve të cilët do të ftohen që të dorëzojnë Tenderët fillestar është:

IV.1.5. Informata në lidhje me ankandin elektronik

Do të përdoret ankandi elektronik: Po Jo

Informata shtese në lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

Çmimi më i ulët

ose

Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Po Jo

Nëse po,

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (*nëse aplikohen*):

i

i

<p>Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/></p> <p>Dokumentet me pages</p> <p><i>Nëse po</i>, çmimi EUR</p> <p>Kushtet dhe metoda e pagesës:</p>
<p>IV.3.2) Afati i fundit për pranim të tenderëve / aplikacioneve:</p> <p><i>data</i> 30.10.2025 <i>koha</i> 13:30:00 <i>vendi</i> e-prokurimi.rks-gov.net</p>
<p>IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar:</p> <p><input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo</p> <p><i>Nëse po</i>, jep arsyetim</p>
<p>IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:</p> <p>Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p> <p><i>Nëse po</i>, vlera e sigurisë së tenderit 3000 euro</p> <p>Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 120 apo muaj</p>
<p>IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:</p> <p>Deri më: data: ditët 90 apo muajt</p>
<p>IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:</p> <p><i>data</i> 30.10.2025 <i>koha</i> 13:30:00 <i>vendi</i> Objekti i Komunës Dragash, zyra nr.8</p>

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

<p>Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për kontratë.</p>
--

V.2) INFORMACIONET SHITESË

<p>Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.</p> <p><i>Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita në punishte etj)</i></p> <p>Shënim operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.</p>
--

Aneksi 5 KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË

Për: **KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI**

DUKE MARRË PARASYSH SE [*Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë "INSI" SH.P.K.*] (më tej "Operatori Ekonomik"), pas pranimit të dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, beson se nevojiten informacionet shitesë ose informacionet sqaruese si në vijim:

Ne kemi shqyrtuar dokumentacionin e tenderit për **Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal 2025-2035**, të publikuar nga Komuna e Dragashit. Duke u bazuar në kërkesat teknike të përcaktuara në dosje, kemi disa pyetje për sqarim, në mënyrë që të sigurohet interpretim i drejtë dhe i barabartë i kritereve:

Sipas dosjes së tenderit, përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale,

1. Kriteri 2.7:

Kërkohej që një inxhinier ose master i diplomuar në inxhinieri kompjuterike të ketë minimum 5 vite përvojë pune profesionale dhe të jetë i **certifikuar me PMP**. Duke pasur parasysh objektin e kontratës, që fokusohet në planifikim hapësinor dhe analizë urbane, a mund të na sqaroni arsyen e vendosjes së certifikatës PMP, e cila do të ishte relevante me një aktivitet që ka të bëjë me menaxhimin e projekteve teknologjike, projekte të IT-së, software, ndërsa është pothuajse jo relevante me ekspertizën në planifikim hapësinor?

2. Kriteri 2.9:

Kërkohen dy gjeodetë të diplomuar, me licencë dhe të certifikuar për GIS. Duke marrë parasysh që Hartimi i PZHK-së kërkon ekspertizë në analizë hapësinore dhe GIS, por jo nevojën për matje milimetrike në terren, dhe faktin se certifikata GIS është e ndarë nga profesioni, pra, është kompetencë teknike, dhe jo profesionale me diplomë, a mund të na sqaroni pse kërkohet **çertifikimi GIS i lidhur me gjeodezinë** dhe pse janë të nevojshëm pikërisht **dy gjeodetë**?

3. Kriteri 3 – Pajisjet gjeodezike:

Në kërkesat e dosjes së tenderit kërkohen pajisje shumë të avancuara gjeodezike, si dronë me sensor LIDAR, stacione totale robotike, GNSS, skanues laser dhe softuer për barazim të pikave gjeodezike. Duke marrë parasysh natyrën e PZHK-së si dokument planifikues strategjik që nuk kërkon matje milimetrike në terren, a mund të na sqaroni arsyen e kërkesës për pajisje kaq të specializuara, dhe lidhjen e tyre të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës?

Ne ju falënderojmë për sqarimet që mund të na ofroni dhe presim përgjigjen tuaj për të siguruar interpretim të drejtë dhe të barabartë të dosjes së tenderit.



Numri i Prokurimit: **621-25-8536-2-1-1** – Titulli **Hartimi i planit zhvillimor Komunal 2025-2035- Dragash**

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj kërkoj marrjen e informacioneve të identifikuara.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri OE:	INSTITUTI I SHKENCËS DHE I TEKNOLOGJISË "INSI" SH.P.K.
Adresa e plotë:	BREGU I DIELLIT, QENDRA TREGTARE, NR. 42, PRISHTINË
I përfaqësuar nga:	
Emri:	ISMAJL BAFTIJARI
Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:	
Data:	23.09.2025
Vula:	

I nderuar Operator Ekonomik,

Në vijim të kërkesës suaj për sqarime shtesë lidhur me Kërkesat e Fletës së të Dhënave të Tenderit (FDT) dhe Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme, Autoriteti Kontraktues, konform dispozitave ligjore dhe dokumentacionit të tenderit, sqaron si më poshtë:

1. Roli i Inxhinierit të diplomuar/Master të Inxhinierisë Kompjuterike me PMP

Ky profil është paraparë për shkak të mungesës së profileve adekuate brenda komunës për fushën e **digjitalizimit, menaxhimit të të dhënave dhe koordinimit të projekteve**. Prandaj është kërkuar një bashkëpunëtor me këto pika të forta, i cili mund të kontribuojë që PZHK të jetë sa më i kompletuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore e teknike.

Roli i tij konkret është:

- **Sistemet e informacionit dhe GIS:** krijimi dhe menaxhimi i databazave hapësinore, integrimi i GIS me modelet urbanistike, automatizimi i mbledhjes së të dhënave.
- **Transformimi digjital dhe Smart City:** integrimi i teknologjive moderne (trafik inteligjent, ndriçim publik, IoT për ujësjellës, mbeturina, energji).
- **Analiza dhe modelimi i të dhënave:** përdorimi i Big Data dhe simulimeve kompjuterike për projeksione të zhvillimit.
- **Menaxhimi i projektit (PMP):** koordinim dhe monitorim sipas standardeve ndërkombëtare, duke siguruar përmbushjen e afateve, buxhetit dhe cilësisë.
- **Siguria kibernetike dhe infrastruktura kritike:** këshillim për mbrojtjen e të dhënave dhe planifikimin e rrjeteve digjitale.

Pra, ky ekspert është paraparë si një **shtesë me vlerë** për të forcuar aspektin digjital dhe menaxherial të PZHK-së.

2. Dy gjeodetë të licencuar dhe të certifikuar në GIS

Kërkesa për dy gjeodetë është e bazuar në:

- **Volumin e madh të punës hartografike:** PZHK përmban dhjetëra harta tematike, që kërkojnë ndarje pune terren–zyrë dhe kontroll cilësie të dyfishtë.
- **Kompetencë ligjore:** vetëm gjeodetët e licencuar mund të garantojnë gjeoreferencimin sipas sistemit kadastral dhe të nënshkruajnë për përgjegjësi profesionale.
- **Certifikimi GIS:** i domosdoshëm për përpunimin dhe integrimin e të dhënave në platformën zyrtare GIS për planifikim hapësinor.
- **Sigurim i cilësisë:** dy profesionistë garantojnë standard të lartë profesional, eliminim të gabimeve dhe përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kombinimi i licencës dhe certifikimit GIS siguron që baza hapësinore e PZHK-së të jetë e saktë, ligjrisht e vlefshme dhe e përpunuar digjitalisht sipas standardeve.

3. Pajisjet gjeodezike të avancuara

Kërkesa për pajisje si dron me LIDAR, stacione totale robotike, GNSS, skaner lazer dhe software për barazim pikash është vendosur për këto arsye:

- **Baza ligjore dhe teknike:** PZHK duhet të përgatitet mbi ortofoto dhe harta të gjeoreferencuara, të integruara në GIS.
- **Funksionaliteti i pajisjeve:** droni me LIDAR dhe kamerë jep ortofoto të sakta edhe në terrene të thyer; GNSS dhe stacionet totale sigurojnë verifikim të saktë; skaneri lazer ofron rievime 3D për zona urbane/monumentale; softueri i barazimit garanton konsistencën e të dhënave.
- **Proporcionaliteti:** pajisjet nuk kërkohen për matje milimetrike, por për të garantuar ortofoto cilësore, modele dixhitale të terrenit dhe integrim të të dhënave në kadastrin zyrtar.
- **Lidhja me objektin e kontratës:** këto pajisje janë të domosdoshme që PZHK të bazohet mbi të dhëna të sakta, të përditësuara dhe të certifikuara teknikisht, duke garantuar ligjshmërinë dhe cilësinë e dokumentit përfundimtar.

Përfundim:

Të tri kërkesat (inxhinieri i kompjuterikës me PMP, dy gjeodetët e licencuar me GIS dhe pajisjet gjeodezike të avancuara) janë të përcaktuara për të garantuar që **PZHK 2025–2033 i Komunës së Dragashit** të hartohet sipas normave ligjore, standardeve teknike dhe praktikave më të mira profesionale, duke ofruar një dokument gjithëpërfshirës, digjital dhe të zbatueshëm.

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: Kuvendi i Komunës Dragash

Për Aktivitetin e Prokurimit: 621-25-8536-2-1-1

Sa i përket tenderit për 077-Hartimi i planit zhvillimor Komunal 2025-2035 - Dragash

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë "INSI" SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Bregu i Diellit, Qendra Tregtare, nr. 42.,

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

044 999 007

(Numri Telefonit)

N/A

(Numri i Faks-it)

Ismajl Baftijari

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

baftijari@gmail.com

(Adresa elektronike)

26.09.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 18.09.2025
Afati i fundit i dorëzimit të tenderëve: 30.10.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 4.3 i Rregullores për Prokurim Publik
Neni 25.17 i Rregullores për Prokurim Publik
Neni 18 i Direktivës 2014/24/EU

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Kuvendi i Komunës së Dragashit, me 18.09.2025 ka publikuar Njoftimin për Kontratë për Aktivitetin e Prokurimit: **077-Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal 2025-2035, me numër prokurimi: 621-25-8536-2-1-1**. Në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FDT), përkatësisht tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale janë paraqitur disa kërkesa për ekspertë dhe pajisje, për të cilat Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” ka parashtruar kërkesë për informacione shtesë më 23.09.2025, për të cilën Autoriteti Kontraktues është përgjigjur më 24.09.2025.

Në përgjigjen e Autoritetit Kontraktues Kuvendi i Komunës së Dragashit janë dhënë disa argumente për përfshirjen e ekspertëve dhe pajisjeve që sipas AK janë të domosdoshme për përgatitjen e një Plani Zhvillimor Komunal.

Pas vlerësimit dhe analizimit të kriterëve të vendosura dhe përgjigjes së marrë nga Autoriteti Kontraktues, konsiderojmë se disa nga kriteret e vendosura janë disproporcionale, jo relevante me natyrën e kontratës dhe kufizuese të konkurrencës së drejtë, duke rënë ndesh me dispozitat ligjore të Prokurimit Publik.

1. Kriteri 2.7 – Inxhinier i diplomuar/Master i Inxhinierisë Kompjuterike i certifikuar me PMP

Ky profil nuk është i lidhur me natyrën e punës së një PZHK-je. Transformimi digjital, Smart City apo siguria kibernetike janë tema të rëndësishme, por nuk janë pjesë përbërëse e kërkesave ligjore dhe përmbajtjes standarde të një PZHK-je. Plani Zhvillimor Komunal nuk është projekt i IT-së, dhe vendosja e një kërkesë që Inxhinieri i Inxhinierisë Kompjuterike të jetë **i certifikuar me PMP**, krijon pengesë të panevojshme konkurruese, duke përjashtuar profesionistë të kualifikuar në inxhinieri kompjuterike që mund të kontribuojnë në projekt, por që nuk kanë këtë certifikim specifik.

PMP është një certifikatë që lidhet me menaxhimin e projekteve që kanë për bazë kryesisht procese, burime dhe shpesh zhvillim të sistemeve IT.

Andaj, Ne si OE konsiderojmë se ky kriter bie ndesh me **Nenin 1 të LPP-së**, sepse përcaktimi i një kërkesë të tillë nuk përmbushë qëllimin e prokurimit publik për përdorim efikas të fondeve publike, pasi kërkesa për PMP nuk ka vlerë të shtuar për kontratën. **Nenin 7 të LPP-së dhe Nenin 18 të Direktivës 2014/24/EU**, sepse kushtëzimi me një certifikatë specifike siç është PMP diskriminon operatorët që kanë ekspertizë relevante (planifikim hapësinor, urbanizëm). Si dhe **Nenin 4.3 të Rregullores për Prokurimin Publik**, sepse kriteri nuk është proporcional me natyrën e kontratës, si dhe **Nenin 25.17 të Rregullores për Prokurimin Publik**, sepse sipas kësaj dispozite kriteret duhet të jenë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, gjë që nuk ndodh në këtë rast.

Kërkesë: Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ky kriter të ndryshohet duke e hequr kushtin për certifikatën PMP, si jo relevante me natyrën dhe qëllimin e kontratës.

2. Kriteri 2.9 – Dy gjeodetë të licencuar dhe të certifikuar për GIS

PZHK kërkon përdorim të dhënave të dokumentuara kadastrale, hartave ekzistuese nga Drejtoria e Kadastrit, Agjencioni Kadastral i Kosovës (parcela, zona kadastrale, ortofoto, harta kadastrale, materiale nga ASK, MMPHI, etj), dhe integrim të tyre në analizë (dhe nuk mundet që dikush të masë parcela dhe vendos pronar veçse institucioneve kompetente).

Pra, sipas dispozitave ligjore përkatëse nuk ka kërkesë ligjore që PZHK të përmbajë matje

gjeodezike të reja në terren dhe nuk ekziston obligim që ato të nënshkruhen nga gjeodetë të licencuar për hartat që kërkohen të punohen, pasi që të njëjtat mund të punohen edhe nga ekspert të tjerë si gjeograf, planer.

Ligji dhe praktikat e deritanishme tregojnë se të dhënat bazë sigurohen nga institucionet përkatëse dhe përdoren për analizë e vizion zhvillimor, jo për shërbime gjeodezie.

Andaj, kërkesa që një OE të angazhojë dy (2) gjeodetë të licencuar dhe certifikuar me GIS, konsiderojmë se është kriter i tepërt dhe i pajustificuar sepse përveç tjerash GIS është mjet pune ndërdisiplinor dhe kompetencë teknike që mund të zotërohet nga profesione të ndryshme, dhe që përdoret nga urbanistë, arkitektë, planifikues hapësinor, ekspert të mjedisit, si dhe shumë profesione të tjera.

Bazuar në të cekurat më lartë, ne si OE konsiderojmë se ky kriter është në kundërshtim me dispozitat ligjore, përkatësisht me **Nenin 7 të LPP-së dhe Nenin 18 të Direktivës 2014/24/EU**, sepse si i tillë është diskriminues dhe kufizon konkurrencën, duke përjashtuar kështu profesionistët e tjerë me kualifikime të barabarta për GIS, si dhe **Nenin 25.17 të Rregullores për Prokurim Publik**, sepse ky kriter nuk lidhet ngushtë me natyrën e kontratës, pasi që GIS është aftësi teknike ndërdisiplinore.

Kërkesë: Kërkojmë që ky kriter të ndryshohet duke e larguar kërkesën për gjeodetë të certifikuar me GIS, si kriter kufizues dhe diskriminues për profesionist të fushave të tjera që përdorin GIS si mjet profesional.

3. Kriteri 3 – Pajisjet gjeodezike të avancuara

Kërkesa për këto pajisje është **jashtëzakonisht disproporcionale dhe e pajustificuar**, pasi që PZHK nuk është projekt për rilevime topografike të reja, por është dokument strategjik që nuk kërkon pajisje të avancuara gjeodezike të përdorura për matje milimetrike në terren.

Kërkesa për një gamë kaq të gjerë pajisjesh i shkon përshtat një kontrate të natyrës inxhinierike apo topografike, por jo një dokumenti politikash zhvillimore dhe hapësinore sikurse është hartimi i një Plani Zhvillimor Komunal. Për më tepër, fakti që është kërkuar që këto pajisje të dëshmohen vetëm përmes faturës tatimore ose DUD-it doganor, përjashton mundësinë e zakonshme të sigurimit përmes qirasë apo marrëveshjeve të tjera të ligjshme, duke kufizuar kështu panevojshëm konkurrencën.

Detyrimi për posedim të këtyre pajisjeve rrit artificialisht kostot e ofertës dhe potencialisht shkakton dëm për buxhetin publik.

Praktikat në të gjitha komunat e Kosovës dhe rajonit tregojnë se PZHK-të janë hartuar pa kërkesa të tilla, duke u mbështetur në të dhënat ekzistuese zyrtare. Këto pajisje përdoren për projekte të specializuara teknike (infrastrukturë, rrugë, ndërtim, etj), jo për hartimin e një Plani Zhvillimor Komunal.

Andaj, ky kriter është në kundërshtim të plotë me **Nenin 4.3 të Rregullores për Prokurimin Publik dhe Nenin 18 të Direktivës 2014/24/EU**, sepse si e tillë kjo kërkesë është joproporcionale me objektin e kontratës dhe krijon barrierë artificiale për operatorët, si dhe **Nenin 7 të LPP-së dhe Nenin 25.17 të Rregullores për Prokurimin Publik**, sepse cenon barazinë dhe diskriminon operatorët ekonomik që përdorin forma të tjera ligjore sigurimi të pajisjeve.

Kërkesë: Kërkojmë që ky kriter të largohet si disproporcionale me objektin e kontratës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Për më shumë, Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” SH.P.K., si kompani me përvojë të gjatë në fushën e planifikimit hapësinor, gjegjësisht, hartimin e Planeve Zhvillimore Komunale, konsideron se kërkesat e parashtruara nga AK nuk janë në

harmoni me natyrën, përmbajtjen dhe praktikat ligjore për hartimin e një PZHK-je. Plani Zhvillimor Komunal është një **dokument strategjik dhe planifikues**, i cili mbulon këto fusha kryesore tematike:

- Karakteristikat e përgjithshme të komunës dhe demografia
- Fusha ekonomike
- Fusha e infrastrukturës teknike
- Fusha e infrastrukturës së transportit
- Fusha e infrastrukturës publike dhe sociale
- Fusha e mjedisit dhe zonave me rrezikshmëri
- Fusha e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike
- Fusha e vendbanimeve
- Fusha e banimit
- Fusha e vendbanimeve joformale (VJF)
- Fusha e shfrytëzimit të tokës

PZHK përfshin analizën e gjendjes ekzistuese, vizionin zhvillimor, objektivat, kornizën hapësinore, projektet prioritare, planin e veprimit, mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimin e kapaciteteve investive. Në këtë kuptim, është e qartë se dokumenti është **politikë zhvillimore dhe planifikim strategjik hapësinor**, dhe jo një proces matjesh gjeodezike apo ndërtimi hartash teknike në nivel milimetrik.

Deri më sot, asnjë komunë në Kosovë apo rajon nuk ka kërkuar profile të tilla për hartimin e PZHK-së, andaj edhe kjo tregon qartë se kërkesat e vendosura nuk janë as të domosdoshme, as të bazuara në legjislacionin për planifikim hapësinor. Përkundrazi, ato krijojnë pengesa artificiale për konkurrencë, duke e orientuar tenderin në favor të një grupi të caktuar operatorësh ekonomikë.

Andaj, duke u bazuar nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të rishqyrtojë dhe të ndryshojë kriteret e FDT-së, në mënyrë që ato të jenë të harmonizuara me parimet e barazisë, transparencës, proporcionalitetit dhe konkurrencës së ndershme.

Autoritetit Kontraktues i propozojmë që të merrë këtë:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar Kërkesa për Rishqyrtim paraqitur nga Operatori Ekonomik Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë „INSI“ SH.P.K., lidhur me kërkesat e FDT sa i përket pikës 2.7, 2.9, dhe 3, në aktivitetin e prokurimit me numër: 621-25-8536-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Dragash.

NDRYSHOHEN kërkesat për pikën 2.7, 2.9, dhe 3 të FDT-së, në aktivitetin e prokurimit: 621-25-8536-2-1-1, si rezultat i shkeljes së parimit të barazisë, transparencës, proporcionalitetit dhe konkurrencës së ndershme.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që shkaktohen nëse aplikohen pikat 2.7, 2.9, dhe 3 të FDT-së, dhe pamundësia e pjesëmarrjes në këtë aktivitet të prokurimit, janë të konsiderueshme si në fushën financiare, ashtu edhe në fitime të munguara. Dëmet do të saktësohen në mënyrë të detajuar gjatë ankesës në OSHP, apo gjykatë, nëse AK nuk e vendos ligjshmërinë në këtë proces.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO
KUVENDI I KOMUNES - SKUPŠTINA OPŠTINE
DRAGASH - DRAGAŠ
ZYRA PËR PROKURIM – KANCELARIJA ZA JAVNU NABAVKU

Zyra per prokurim ne Dragash, ne bazë te kërkesës per rishqyrtim te bërë me datë 26.09.2025 nga Operatori Ekonomik “ INSI- Sh.p.k “-Prishtine, ne lidhje me aktivitetin e Prokurimit 077 “ Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal me validitet 10 vjeqar ne Dragash(projekt dy vjeqar), me numër identifikues: 621-25-8536-2-1-1, dhe nr, te mbrendshem 621-2025-077-211. , dhe duke u bazuar ne Rregulloren Nr/001-2022(te konsoliduar) nenin 63.1.1 nen b), të kësaj rregulloreje-të aprovuara nga Komisioni Rregullativ I Prokurimit Publik I cili ne pajtim me Nenin 87.2.4 ,të Ligjit mbi prokurimin Publik nr.04/L-042,I ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-237,ligjin nr.05/L-068 dhe ligjin nr.05/L-092, bjen këtë :

V E N D I M

- 1. Refuzohet si e pa bazuar për Rishqyrtim kërkesa e OE “ INSI- Sh.p.k “-Prishtine**
- 2. Mbetet në fuqi Njoftimi per kontrate I Autoritetit Kontraktues i datës 18.09.2025.**

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues Komuna e Dragashit ka bere rishqyrtimin sipas kerkeses tuaj dhe ka konstatuar si me poshte:

I nderuar Operator Ekonomik,

Në vijim të kërkesës për rishqyrtim lidhur me Kërkesat e Fletës së të Dhënave të Tenderit (FDT) dhe Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme, Autoriteti Kontraktues, konform dispozitave ligjore dhe dokumentacionit të tenderit, sqaron si më poshtë:

1. Roli i Inxhinierit të diplomuar/Master të Inxhinierisë Kompjuterike me PMP

Ky profil është paraparë për shkak të mungesës së profileve adekuate brenda komunës për fushën e **digjitalizimit, menaxhimit të të dhënave dhe koordinimit të projekteve**. Prandaj është kërkuar një bashkëpunëtor me këto pika të forta, i cili mund të kontribuojë që PZHK të jetë sa më i kompletuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore e teknike.

Roli i tij konkret është:

- **Sistemet e informacionit dhe GIS:** krijimi dhe menaxhimi i databazave hapësinore, integrimi i GIS me modelet urbanistike, automatizimi i mbledhjes së të dhënave.
- **Transformimi digjital dhe Smart City:** integrimi i teknologjive moderne (trafik inteligjent, ndriçim publik, IoT për ujësjellës, mbeturina, energji).
- **Analiza dhe modelimi i të dhënave:** përdorimi i Big Data dhe simulimeve kompjuterike për projeksione të zhvillimit.
- **Menaxhimi i projektit (PMP):** koordinim dhe monitorim sipas standardeve ndërkombëtare, duke siguruar përmbushjen e afateve, buxhetit dhe cilësisë.
- **Siguria kibernetike dhe infrastruktura kritike:** këshillim për mbrojtjen e të dhënave dhe planifikimin e rrjeteve digjitale.

Pra, ky ekspert është paraparë si një **shtesë me vlerë** për të forcuar aspektin digjital dhe menaxherial të PZHK-së.

2. Dy gjeodetë të licencuar dhe të certifikuar në GIS

Kërkesa për dy gjeodetë është e bazuar në:

- **Volumin e madh të punës hartografike:** PZHK përmban dhjetëra harta tematike, që kërkojnë ndarje pune terren–zyrë dhe kontroll cilësie të dyfishtë.
- **Kompetencë ligjore:** vetëm gjeodetët e licencuar mund të garantojnë gjeoreferencimin sipas sistemit kadastral dhe të nënshkruajnë për përgjegjësi profesionale.
- **Certifikimi GIS:** i domosdoshëm për përpunimin dhe integrimin e të dhënave në platformën zyrtare GIS për planifikim hapësinor.
- **Sigurim i cilësisë:** dy profesionistë garantojnë standard të lartë profesional, eliminim të gabimeve dhe përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kombinimi i licencës dhe certifikimit GIS siguron që baza hapësinore e PZHK-së të jetë e **saktë, ligjërishit e vlefshme dhe e përpunuar digjitalisht sipas standardeve**.

3. Pajisjet gjeodezike të avancuara

Kërkesa për pajisje si dron me LIDAR, stacione totale robotike, GNSS, skaner lazer dhe

software për barazim pikash është vendosur për këto arsye:

- **Baza ligjore dhe teknike:** PZHK duhet të përgatitet mbi ortofoto dhe harta të gjeoreferencuara, të integruara në GIS.
- **Funksionaliteti i pajisjeve:** droni me LIDAR dhe kamerë jep ortofoto të sakta edhe në terrene të thyer; GNSS dhe stacionet totale sigurojnë verifikim të saktë; skaneri lazer ofron rievime 3D për zona urbane/monumentale; softueri i barazimit garanton konsistencën e të dhënave.
- **Proporcionaliteti:** pajisjet nuk kërkohen për matje milimetrike, por për të garantuar ortofoto cilësore, modele dixhitale të terrenit dhe integrim të të dhënave në kadastrin zyrtar.
- **Lidhja me objektin e kontratës:** këto pajisje janë të domosdoshme që PZHK të bazohet mbi të dhëna të sakta, të përditësuara dhe të certifikuara teknikisht, duke garantuar ligjshmërinë dhe cilësinë e dokumentit përfundimtar.

Përfundim:

Të tri kërkesat (inxhinieri i kompjuterikës me PMP, dy gjeodetët e licencuar me GIS dhe pajisjet gjeodezike të avancuara) janë të përcaktuara për të garantuar që **PZHK 2025–2033 i Komunës së Dragashit** të hartohet sipas normave ligjore, standardeve teknike dhe praktikave më të mira profesionale, duke ofruar një dokument gjithëpërfshirës, digjital dhe të zbatueshëm.

Prandaj ne fund vendoset si ne dispozitiv te ketij vendimi.

Keshilla juridike: Pala e pa kenaqur sipas nenit 109 te ketij Ligji, mund te ankohet ne Organin Shyrtues te Prokurimit Publik te Kosoves ne afat prej 10 ditesh, nga marrja e ketij vendimi

Dragash 30.09.2025

U.D-zyrtari pergjegjes per prokurim
Fadil Sinani





NLB BANKA BREGU DIELLIT.

Deponim në llogari të bankës

DF-01

24301541729

DEPOSIT FORM

1700-0736-000001.09

Emri i klientit/ NLB PRISHTINA

Customer name:

Llogaria nr/

Nr. llog. 1700-0736-000001.09

Në llogarinë/Account 1,505.00 EUR

Me fjale: një

In words: thousandfiveh

Efektiva/Cash 1,500.00 EUR

Me fjale: një mijëpesëqind

In words: thousandfivehundred

Uniref Acc.: 1000-4300-700057.56

Uniref Name: OSHP Organi Shqyrtues i Prokurimit

Emri Mb. Kompania
Përshkrimi

INSTITUTI I SHKENCES DHE I TEKNOLOGJISE INSI SH.P.K., BREGU I DIELLIT-
077 HARTIMI I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL 2025-2035-DRAGASH NR

UNIREF

PPQDD1111111111H

përshkrimi OSHP ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

09.10.2025

Data / data

10 5300 1 4 09.10.2025 14:02

Nënshkrimi digjital

Saldo / përmbajtja

Account description

Fee

Balance:

IblBeAccDescription

Exchange rate/Exchange rate

1.0000

EUR	Notes:
500.00	0.00
200.00	0.00
100.00	14.00
50.00	2.00
20.00	0.00
10.00	0.00
5.00	1.00
Coins:	
2.00	0.00
1.00	0.00
0.50	0.00
0.20	0.00
0.10	0.00
0.05	0.00
0.02	0.00
0.01	0.00

Nënshkrimi /1.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS / SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEW BODY



PAGESE PËR DEPOZITË PËR SIGURIM TË ANKESËS
PLAÇANJE ZA SIGURNOST DEPOZITA ŽALBE
PAYMENT FOR THE SECURITY DEPOSIT OF THE COMPLAINT



UNIREF
PPQDD11111111111H

Të dhënat e OE
Podaci EO
EO data

Instituti i Shkencës Dhe i Teknologjisë Insi SH.P.K., BREGU I DIELLIT - QENDRA
TREGTARE LOK.NR.42, 10000 PRISHTINË

Përshkrimi
Opis
Description

077-Hartimi i planit zhvillimor Komunal 2025-2035- Dragash

Numri i prokurimit
Broj nabavke
Procurement number

621-25-8536-2-1-1

Shuma / Iznos
Amount

€ 1 500 000 Euro 00 Ct Data / Datum / Date 09 10 2025

Me fjalë / Reçima
In words

N j ë m i j ë e p e s ë q i n d e u r o e z e r o c e n t

Xhironlogaria
Broj žiroračuna
Bank account

1 0 0 0 4 3 0 0 7 0 0 0 5 7 5 6

Lëshuar nga
Izdato od /
Issued by

OSHP

Nënshkrimi dhe vula e bankës
Potpis i pečat banke
Bank signature and stamp

14.2 Ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP.

a. Kurdo që ankesa ndërlihet me vendimin për shpërbllim të një kontrate, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

b. Kurdo që aneksa ndërlihet me njëftimin për kontratë, dokumentet e tenderit, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

14.2 U skladu sa članom 118 ZJN, svi podnosioci žalbe moraju platiti žalbu u TRN.

a. Kad god se žalba odnosi na odluku o dodeli ugovora, iznos žalbene naknade iznosi jedan procenat (1%) od vrijednosti ponude, ali ne manje od 100 € i ne više od 5.000 €.

b. Kad god se aneks odnosi na obaveštenje o ugovoru, tenderska dokumentacija, iznos naknade za žalbu iznosi jedan procenat (1%) od procenjene vrednosti, ali ne manje od 100 evra i ne više od 5.000 evra.